

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR 2023



Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, përkrah përfaqësuesve të institucioneve të tjera zhvilloi Vizitën Studimore, të organizuar nga Expertise France, me qëllim shkëmbimin e praktikave dhe eksperiencave me institucionet kryesore që bejnë të mundur funksionimin e Ndhmës Juridike Falas, në Francë.



Vizituam Ministrinë franceze të Drejtësisë, Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, Qendrën Informative për të Drejtat e Grave dhe Familjet (CIDFF Centre Information sur Droits des Femmes et Familles), takim me Avokat Anastasia PITCHOUGUINA, avokate pranë Dhomës së Avokatit të Parisit, AFPA (Agjencinë Kombëtare për Trajnimin Profesional të të Rriturve), France Service Bobigny, ofrimi i shërbimit dixhital dhe fizik, Qendrën e Punësimit, si dhe Agjencinë Franceze të Zhvillimit (AFD).



Mbyllëm me sukses “Trajnimin e Trajnerëve” në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë, me mbështetjen e Agjencisë Austriake për zhvillim, si pjesë e projektit “Zgjerimi i shërbimeve ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”.

Programi u fokusua në Ankimin Individual Kushtetues.

Me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, realizuam Trajnimin “Mbi Udhëzuesin e ri të komunikimit dhe pritjes së qytetarëve, pjesë e kategorisë së veçantë/vulnerabël nga specialistët e Qendrave të Shërbimit”.



Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në konferencën shkencore me temë "Society in transformation: challenges and opportunities" (30 years of Sociology at the University of Tirana), organizuar nga Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Tiranës.

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR 2023

LEKSIONE TE HAPURA, në kuadër të bashkëpunimit me 12 Klinikat e Ligjit, pranë Universiteteve të Arsimit të Lartë.



Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Mesdhetar



Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Luarasi



Gjatë muajit Nëntor 2023 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, referuar Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, të lidhura me 12 Universitete të Arsimit të Lartë, kanë zhvilluar 3 Leksione të Hapura.

Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Kavajë dhe Durrës, pranë Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike, pranë UAMD

AKTIVITETE TË ZHVILLUARA NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Durrës

Në datën 06.11.2023, QSHNJP Durrës zhvilloi një takim ndërgjegjësues dhe informues mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë "Promovimi i ndihmës juridike falas", si pjesë e së drejtës së aksesit në drejtësi, në bashkëpunim me Sektorin e marrëdhënieve me publikun, në Bashkinë Durrës.



Tropojë

Në datën 08.11.2023, QSHNJP Tropojë mori pjesë në takimin e organizuar nga Shoqata "Integrimi" me gra dhe vajza pjesë të familjeve që përfitojnë nga skemat sociale, ku ishin të pranishme gra dhe vajza nga komuniteti rom/ egjiptian.



Në kuadër të aktiviteteve promovuese për hapjen e Qendrës, në datën 09.11.2023, QSHNJP Tropojë zhvilloi një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Bujan Z.Sherif Vatoci dhe specialistë pranë këtij institucioni. Pjesëmarrësit shprehën gadishmërinë për bashkëpunim ndërinstytucional.



Në datën 09.11.2023, QSHNJP Tropojë zhvilloi një takim me stafin e Qendrës Shëndetësore Bujan, ku u diskutua rreth kategoritë përfituese, si viktimat e dhunës, viktimat abuzimit seksual dhe personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me personelin shëndetësor.

Lushnjë

Në datën 03.11.2023, QSHNJP Lushnjë mori pjesë në aktivitetin me temë "Bashkëpunim i shoqatës "Romacted" me Bashkinë Roskovec dhe Bashkinë Lushnjë".



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR 2023

Përmet

Në datën 24.11.2023, QSHNJP Përmet realizoi një takim për subjektet përfituese të Ligjit Nr. 111/2017 " Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti". Aktiviteti u zhvillua me punonjëset e një fasonerie.



Në datën 30.11.2023 QSHNJP Përmet mori pjesë në konsultimin e Planit të Kujdesit Social të zhvilluar në ambientin e mbledhjeve në Sallën e Këshillit Bashkiak

Bashkëpunimi midis QSHNJP Përmet & QSHNJP Gjirokastrë

Në datën 08.11.2023 në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informuese si dhe urës së bashkëpunimit ndërmjet dy qendrave u vijua me zhvillimin e aktivitetit pranë Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, si dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Gjirokastrë.



Gjirokastrë

Në datën 06.11.2023, QSHNJP Gjirokastrë realizoi një aktivitet me përfaqësues të DNJF, pranë Njesisë Administrative Vrisera, Dropull. Aktiviteti u organizua nga QSHNJP Gjirokastrë në bashkëpunim me Avokaten e Popullit, Dropull.



Korçë

Në datën 13.11.2023, QSHNJP Korçë mori pjesë në takimin e realizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, me pjesëmarrjen e institucioneve lokale, në kuadër të të drejtave të njeriut.



Në datën 22.11.2023, QSHNJP Korçë mori pjesë në takimin e realizuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, në kuadër të diteve portokalli, mbi sensibilizimin ndaj Dhunës në marrëdhëniet familjare.




Në datën 24.11.2023, QSHNJP Korçë mori pjesë në aktivitetin informues të realizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, për hapjen e fushatës në kuadër të Ditës Ndërkombetare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.



Në datën 28.11.2023, QSHNJP Korçë mori pjesë në aktivitetin e realizuar nga Bashkia Korçë me rastin e 111 vjetorit të Pavarsisë.

Kukës

Në datën 08.11.2023, QSHNJP Kukës mori pjesë në takimin informues me temë dhënien e informacionit të detajuar lidhur me rolin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky takim u realizua nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Kukës, mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



Elbasan

Në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, QSHNJP Elbasan, përgjatë muajit nëntor ka realizuar afishimin e posterave në ambientet hyrëse të institucioneve kryesore, si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Elbasan, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR 2023

Pogradec

Në datën 15.11.2023, QSHNJP Pogradec mori pjesë në takimin e organizuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Grave në Shqipëri – AWEN, në bashkëpunim me shoqatën “Unë, Gruaja” Pogradec. Qëllimi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje, Bashkia Pogradec, me qëllim për të adresuar në mënyrë sa më efektive nevojat e të mbijetuarave të DhBGj/DHF.



Në datën 22.11.2023, QSHNJP Pogradec mori pjesë në takimin e organizuar nga Këshilli Bashkiak, ku Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Pogradec realizoi konsultimin e Planit të Kujdesit Social 2024-2027.



Në datën 24.11.2023, QSHNJP Pogradec mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Pogradec, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve”, në bashkëpunim me shoqatën “Unë Gruaja”, në kuadër të “16 Ditë Aktivizëm kundër Dhunës me Bazë Gjinore ndaj Grave dhe Vajzave 25 nëntor - 10 dhjetor 2023”.

Pukë

Në kuadër të aktiviteteve promovuese dhe ndërgjegjësuese, në datën 22.11.2023, QSHNJP Pukë realizoi një takim me punonjës të pastrim gjelbërimit, pranë Bashkisë Pukë.



Në datën 23.11.2023, QSHNJP Pukë realizoi një takim me pjesëmarrës nga institucione të tjera lokale dhe qytetare të ndryshëm, në bashkëpunim me Kordinatoren për Dhunën në Familje pranë Bashkisë Fushe-Arrëz.

Mat


Në datën 08.11.2023, QSHNJP Mat realizoi një takim informues në shkollën e mesme të bashkuar në Njësinë Administrative Komsj.



Në datën 08.11.2023, QSHNJP Mat realizoi një takim informues në ambientet e njësisë administrative Komsj, me specialisten e Ndihmës Ekonomike dhe Sociale,

Kurbin

Në kuadër të prezantimit dhe informimit të aktivitetit të QSHNJP Kurbin zhvilloi një takim bashkëpunues me instancat e shërbimit social, të vendosura pranë Bashkisë Kurbin, me datë 03.11.2023. U prezantua roli i Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Falas, duke i kërkuar adresimin e problematikave juridike të viktimave të dhunës në familje, pranë kësaj Qendre, aty ku viktimat do të kenë akses për të gjetur zgjidhjen e çdo problematike.



Gjatë këtij muaji QSHNJP Kurbin ka realizuar aktivitete në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese, në bashkëpunim me World Vision Albania, dega Kurbin, me tematikë fuqizimin e komunitetit të Kurbinut dhe mbështetje të grupeve në nevojë.

